



Nr. 3054 / prot.

7



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I ELBASANIT "ALEKSANDËR XHUVANI"
BORDI I ADMINISTRIMIT

Elbasan, më 15.12.2023

VENDIM

Nr. 44 datë 15.12.2023

**"PËR RIORGANIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT TË CIKLIT TË DYTË
MASTER PROFESIONAL NË MËSUESI PËR ARSIMIN E MESËM TË ULËT PËR
BIOLOGJI-KIMI ME PROFIL MINOR NË EDUKIM SHENDETSOR, NË
PROGRAMIN E STUDIMIT MASTER I SHKENCAVE NE MËSUESI PËR BIOLOGJI-
KIMI, NËDEPARTAMENTIN E METODOLOGJIVE TË MËSIMDHËNIES NË
FAKULTETI I SHKENCAVE TË EDUKIMIT"**

Bazuar në Ligjin. Nr 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë" neni 3, pika 2, germa "b"; nenin 35, pika 9, neni 38, pika 1, germa "dh" në Urdhrin nr. 225, datë 07.05.2018 "Për përafrimin e përmbajtjes së programeve të studimit në fushën e mësuesisë të institucioneve të arsimit të lartë", në Udhëzimin nr.1, datë 14.01.2020 i Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë "Për dokumentacionin dhe procedurat dhe procedurat për hapjen, riorganizimin dhe mbylljen e institucionit të arsimit të lartë, degëve të tyre, njërive kryesore dhe programeve të studimit si dhe për ndarjen ose bashkimin e IAL", Kreu IV si dhe në Udhëzimin nr.10, datë 30.03.2020 të Ministrit të Arsimit dhe Sportit "Për përcaktimin e elementëve përbërës, formën e diplomës ose certifikatës të lëshuar nga IAL dhe procedurës së regjistrimit të tyre në regjistrin shtetëror të diplomave dhe certifikatave për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor", i ndryshuar, Bordi i Administrimit,

V E N D O S I :

1. Të miratojë propozimin e Fakultetit të Shkencave të Edukimit riorganizimin e programit të studimit Master profesional në "Mësuesi në arsimin e mesëm të ulët për biologji-kimi me profil minor në edukim shëndetësor dhe mjedisor" në Master i shkencave në "Mësuesi për Biologji-kimi".
2. Diploma ekzistuese Master profesional në "Mësuesi në arsimin e mesëm të ulët për Biologji-kimi me profil minor në edukim shëndetësor dhe mjedisor" të bëhet **Master i shkencave në "Mësuesi për Biologji-kimi"**.
3. Të miratojë formën e diplomës për programin e studimit të ciklit të dytë Master i shkencave në Mësuesi për "Biologji-kimi" (modeli bashkëngjitur).
4. Ky vendim t'i përcillet Ministrisë së Arsimit dhe Sportit për procedura të mëtejshme. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I BORDIT
ARDIAN DURMISHI